



**Hapet thirrja për mobilitete (bursa) studentësh të UPT-së,
në kuadër të Marrëveshjes KA1 të Programit Erasmus+,
në University of Ruse, BULGARIA**

Në kuadër të programit Erasmus+ dhe marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës, në University of Ruse.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve të nivelit Bachelor, Master dhe Doktoraturë, për studime.

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- **Bachelor** (Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Bachelor, në Universitetin Politeknik të Tiranës, **Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit**).
- **Master** (Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Master, në Universitetin Politeknik të Tiranës, **Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit**).
- **Doktoraturë** (Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Master, në Universitetin Politeknik të Tiranës, **Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit** ose **Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike**).

Kohëzgjatja e bursave: Semestri i II i vitit akademik 2023 - 2024

Numri total i studentëve për mobilitet - 4 studentë

Dokumentat e nevojshme për aplikim:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Listë notash e studimeve, deri në momentin e aplikimit;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Çertifikatë e gjuhës së huaj*;
- Dokumenti Learning Agreement**.



Key Action 1
– Mobility for learners and staff –

**Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze, ku niveli minimal i kërkuar për gjuhën është B2. Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar të gjuhës duke e vërtetuar me certifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.*

***Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë ‘‘Mobility Plan’’. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës, kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në University of Ruse lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryenit në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Dokumenti ‘‘Learning Agreement’’ te seksioni ‘‘Commitment’’ firmoset nga aplikanti, nga Koordinatori Akademik i Fakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

Për të shkarkuar formatin e ‘‘Learning Agreement’’ klikoni te:

[Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit – Universiteti Politeknik i Tiranës \(upt.edu.al\)](https://upt.edu.al) , aneks 2.

Për të parë listën e lëndëve dhe për të marrë informacion të përgjithshëm rreth studimeve në University of Ruse klikoni te:

<http://www.ecs.uni-ruse.bg/index.php?step=21500891>

Afati për aplikim: Deri më 30 Tetor 2023, ora 12.00

Aplikimi kryhet pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT.

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në email:

abeqo@upt.al , rkodra@upt.al